



Komisioni Komunal për Vlerësimin e Ofertave dhe Zbatim të Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës

Dt.14.12.2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L040, Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2004 për Procedurën, Formën dhe Përmbajtjen e Konkursit, Kushtet dhe Kriteret për Vendosjen e Subjekteve Afariste Brenda Hapësirave të Zonave Ekonomike, Statutit të Komunës, Komisioni Vlerësues shpallë këtë:

NJOFTIM

Përmes këtij njoftimi, Komisioni Komunal për Vlerësimin e Ofertave dhe Zbatim të Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës njofton të gjitha Subjektet Afariste që të ketë parasysh sygjerimet e mëposhtme:

I. Në pikën **4 (katër) “Ngastra për të cilën Aplikoni”** në Formularin për Aplikim, tek numri i Ngastrës duhet të shenohen të dy ngastrat Kadastrale P-70202011-00435-1 dhe P-70202011-00435-3. Ndërsa te rubrika **“Sipërfaqja”**, të shënohet minimumi dhe maksimumi i sipërfaqës e cila do t’i plotësonte nevojat e Subjektit Afarist.

II. Projekti Ideor i cili prezantohet nga Subjekti Afarist të jetë konformë sipërfaqës së kërkuar nga Subjekti Afarist në formularin për Aplikim.